

Airbnb ka dyfishuar gjuhët që ofrohet

Airbnb është platforma më e madhe në botë për vende unike dhe autentike për të qëndruar, ose për aktivitete, duke ofruar mbi 7 milionë strehime dhe 40 000 aktivitete artizanati, të gjitha të mundësuar nga organizatorët vendas. Çdo sekondë rreth gjashtë vizitorë regjistrohen në listimet e Airbnb. Dhe këto regjistrime kryhen anembanë botës: Në 2011, ishin 12 qytete me më shumë se 1 000 listime Airbnb; sot, pothuajse 1 000 qytete kanë më shumë se 1 000 listime Airbnb. Po kështu, në vitin 2011 vetëm një qytet mirëpriti mbi 100 000 vizitorë në listimet e Airbnb, por vitin e kaluar, më shumë se 300 qytete kanë mirëpritur mbi 100 000 vizitorë.

Tani Airbnb përdoret në më shumë se 191 vende dhe rajone anembanë botës, dhe ne jemi duke punuar vazhdimisht që platforma jonë të përdoret nga sa më shumë njerëz. Nga Anglishtja e deri në Zulu, pavarësisht se çfarë gjuhe flasim, ne duam që të gjithë të ndjehen të mirëpritur në Airbnb.

Sot, po dyfishojmë numrin e gjuhëve në të cilat hostët dhe vizitorët mund të përdorin Airbnb. Tani duke mbështetur 62 gjuhë anembanë botës, platforma Airbnb është e prekshme për më shumë se 4 miliardë folës gjuhësh amtare. Me këto gjuhë të reja, po punojmë për të sjellë mundësi ekonomike edhe për hostët të tjerë; dhe për ta bërë më të lehtë për më shumë vizitorë që udhëtimi i tyre të ketë përjetime lokale, autentike dhe unike.

Këto janë 31 gjuhët e reja që janë të disponueshme në Airbnb:

1. Anglisht (Australi)
2. Anglisht (Kanada)
3. Anglisht (Mbretëri e Bashkuar)
4. Armenisht (Armeni)
5. Azere (Azerbaixhan)
6. Bosnjisht (Bosnjë)
7. Bullgarisht (Bullgari)
8. Estonisht (Estoni)
9. Frëngjisht (Kanada)
10. Gjeorgjisht (Gjeorgji)
11. Indisht (Indi)
12. Irlandisht (Irlandë)
13. Kineze tradicionale (Hong Kong SAR)
14. Letonisht (Letoni)
15. Lituanisht (Lituani)
16. Maqedonisht (Maqedonia e Veriut)
17. Maltisht (Maltë)
18. Malazeze (Mali i Zi)
19. Rumanisht (Rumani)
20. Serbisht (Serbi)
21. Shqip (Shqipëri)
22. Sllovakisht (Sllovaki)
23. Sllovenisht (Slloveni)
24. Spanjisht (Argjentinë)

25. Spanjisht (Amerikë Latine)
26. Svahili (Afrikë)
27. Tagalog (Filipine)
28. Ukrainisht (Ukrainë)
29. Vietnamisht (Vietnam)
30. Xhosa (Afrikë e Jugut)
31. Zulu (Afrikë e Jugut)

Tani për hostët dhe vizitorët tanë që përdorin faqen e internetit ose aplikacionin Airbnb, është e lehtë të kalojnë në një gjuhë të re. Në desktop kliko [këtu](#) për të zgjedhur një gjuhë. Aplikacionet tona për celular përdorin gjuhën e zgjedhur në cilësimet e pajisjes. Për ta ndryshuar, përdoruesit thjesht mund të shkojnë tek cilësimet në pajisjen e tyre për të ndryshuar gjuhën në një nga gjuhët e reja që ofrojmë tani.